

VENDIM
Nr. 00-2025-1733 (87), datë 3.4.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Ilir Panda kryesues;

Medi Bici anëtar;

Sokol Binaj anëtar;

Albana Boksi anëtare;

Sandër Simoni anëtar,

sot, më datë 3.4.2025, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: R. H.

Palë pjesëmarrëse: Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

OBJEKTI: Shfuqizim mase disiplinore

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarës Albana Boksi, prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Arqilea Koça, i cili kërkoi “Prishjen e vendimit nr. 12-2020-1895 (369), datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, dhe vendimit nr. 10-2021-801 (128), datë 28.4.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Enton Duka, i cili kërkoi: “Pushimin e gjykimit të çështjes”, mbrojtësin e të gjykuarit, avokat Alban Nastasaj, i cili kërkoi: “Pushimin e gjykimit të çështjes”, dhe e bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim:

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi R. H. ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë kërkesën me objekt “Shfuqizimin e masës disiplinore”. Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se, në datë 6.12.2019, rreth orës 23:30 grupi i kontrollit të sigurisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve gjatë kontrollit të ushtruar në godinën nr. 2, dhoma nr. 2, të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Rrogozhinë, dhomë në të cilën qëndronte, ndër të tjerë edhe i dënuari R. H., kanë gjetur mbrapa televizorit, afër dritares, një telefon në karikim.

2. Lidhur me këtë fakt është mbledhur Komisioni Disiplinor i IEVP Rrogozhinë, i cili, me vendimin nr. 4162/1, datë 9.12.2019, ka vendosur t’i japë të dënuarit R. H. masën disiplinore “20 (njëzet) ditë përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta”, me arsyetimin se ka shkelur nenin 116, pika 2, shkronja “e”, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i dënuari R. H. Me vendimin nr. 171, datë 23.12.2019, Komisioni ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 4162/1, datë 9.12.2019, të marrë nga Komisioni Disiplinor i IEVP Rrogozhinë për dhënien e masës disiplinore ndaj të dënuarit R. H.”.

3. Kundër vendimeve të mësipërme ka paraqitur ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit, i dënuari R. H., duke pretenduar se as ka mbajtur dhe as ka përdorur

celularin. Sipas kërkesës, ky celular i përkiste një tjetër të dënuari, i cili edhe është proceduar dhe dënuar nga gjykata.

4. Seanca gjyqësore në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit është zhvilluar me praninë e mbrojtësit të zgjedhur të të dënuarit kërkuar dhe përfaqësuesit të IEVP Rrogozhinë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2020-1895 (369), datë 22.12.2020**, ka vendosur: “1. *Pranimin e kërkesës. 2. Shfuqizimin e masës disiplinore të dhënë prej Komisionit Disiplinor të IEVP Rrogozhinë me vendimin nr. 4162/1, datë 9.12.2019, lënë në fuqi me vendimin nr. 171, datë 23.12.2019 nga Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.*”, duke arsyetuar, se: “... nuk është respektuar procedura e parashikuar nga ligji, mbledhja e Komisionit Disiplinor, brenda afatit të përcaktuar dhe njëkohësisht nuk provohet shkelja për të cilën është vendosur masa disiplinore.”.

6. Kundër këtij vendimi, ka paraqitur **ankim** Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me anë të të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës parë dhe pushimin e gjykimit pasi gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur juridiksion për shqyrtimin e kërkesës.

7. **Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-801 (128), datë 28.4.2021**, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit penal nr. 12-2020-1895 (369), datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.”.

8. Gjykata e Apelit Durrës, ndër të tjera, ka arsyetuar se, ... drejtë ka konkluduar gjykata e faktit në lidhje me procedurën, afatin e mbledhjes së Komisionit Disiplinor, pasi çmohet se thirrja dhe mbledhja e tij është bërë tej afatit të përcaktuar nga neni 54 i ligjit dhe 119/6 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, pra tej afatit 48 orë dhe 24 orë nga momenti i konstatimit të shkeljes. Shkelja ka ndodhur (është konstatuar) në datën 6.12.2019 dhe Komisioni Disiplinor është thirrur dhe mbledhur prej drejtorit të IEVP Rrogozhinë në datën 9.12.2019. Prej titullarit është thirrur mbledhja e Komisionit Disiplinor pas vënies në dijeni nga grupi i kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me datën 6.12.2019. Nga ana e titullarit të IEVP Rrogozhinë nuk mund të ngrihet dhe fillonte procedimi disiplinor tej afatit 24 orësh nga shkelja. Kjo nënkupton se organet e IEVP Rrogozhinë paralelisht me policinë gjyqësore, duhej të fillonin dhe përfundonin procedimin disiplinor në përputhje me afatet ligjore 24 orë nga shkelja. Procedimi penal dhe procedimi disiplinor ecin paralelisht dhe duhet të kishin ecur si të tillë dhe jo të pritej referimi nga policia gjyqësore, për sa kohë ligji i ka caktuar si organe kompetente ekskluzive për iniciimin e procedimit disiplinor. (...) fakti mbi të cilin është dhënë masa disiplinore, nuk rezultoi i vërtetë, pasi dy punonjësit që kishin kryer kontrollin (Xh. V. dhe A. M.) deklaruan se ata nuk kishin parë që i dënuari R. H., apo ndonjë tjetër të përdorte, apo t'i përkiste telefoni i gjetur. Sipas procedurës të gjithë të dënuarit ishin jashtë qelisë dhe nga kontrolli telefoni u gjet pas televizorit, në karikim. Gjithashtu, nga vendimi nr. 77, datë 10.9.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë rezulton se është marrë i pandehur dhe është dënuar për rastin vetëm shtetasi Sh. K. për kryerjen e veprës penale të “Futjes, ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim”, parashikuar nga neni 324/a/1 i KP. Masa disiplinore është vendosur për shkeljen e parashikuar nga neni 116/2/e të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve: “2. *Konsiderohen shkelje shumë të rënda disiplinore: e) mbajtja, përdorimi dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara, kur përbëjnë vepër penale*”, dhe fakti mbi të cilin është bazuar masa, nuk rezultoi i vërtetë. (...) nuk është respektuar procedura e parashikuar nga ligji, mbledhja e Komisionit Disiplinor brenda afatit të përcaktuar dhe njëkohësisht nuk provohet shkelja për të cilën është vendosur masa disiplinore. Prandaj me të

drejtë, gjykata e faktit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e masës disiplinore të dhënë prej Komisionit Disiplinor të IEVP Rrogozhinë me vendimin nr. 4162/1, datë 9.12.2019, lënë në fuqi me vendimin nr. 171, datë 23.12.2019 nga Komisioni i Apelit të Masave Disiplinore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Për të gjitha sa u cituan më lart, gjykata e apelit çmon se ky vendim është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj dhe si tillë duhet të lihet në fuqi.

9. Kundër këtij vendimi, me datë 30.4.2021, **ka paraqitur rekurs Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve**, i cili ka kërkuar prishjen e dy vendimeve dhe rrëzimin e kërkesës së R. H. Në rekurs, ndër të tjera, janë parashtruar këto shkaqe:

- Celulari ka qenë në vend të dukshëm dhe të gjithë në dhomë kanë pasur dijeni për të pavarësisht se e ka marrë përsipër njëri nga të dënuarit e dhomës.

- Në një rast tjetër të njëjtë, i njëjti gjyqtar ka mbajtur qëndrim tjetër.

- Në nenin 54/2 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim e të paraburgosurve”, si dhe në nenin 121 të VKM-së nr. 437, datë 20.5.2015, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të burgjeve” nuk parashikohet në mënyrë të shprehur e drejta e ankimit në gjykatë ndaj vendimeve të Komisionit të Apelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

- Sipas nenit 407, pikat 1 dhe 4 të KPP-së, nga terminologjia e përdorur në këtë dispozitë, rezultojnë i qartë vullneti i ligjvënësit për të njohur të drejtën e ankimit vetëm nëse e ka shprehur qartë një të drejtë të tillë mbi natyrën e vendimit apo urdhrin të gjykatës, sikundër edhe të subjekteve që ua njeh këtë të drejtë.

- Në kushtet që gjykata e shkallës së parë e ka pranuar për shqyrtim ankimin e të dënuarit dhe ka pranuar kërkesën e tij, ndërkohë që nuk ka pasur juridiksion për shqyrtimin e tij, vendimi i dhënë nga kjo gjykatë duhet të priset dhe të vendoset pushimi i gjykimit.

II. Nevoja për njësim të praktikës gjyqësore dhe qëndrimet e palëve

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, ka marrë në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi në datën 4.12.2024. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi se, për shkak të subjektit që ka paraqitur rekursin objekt shqyrtimi dhe natyrës së çështjes të shqyrtuar nga gjykatat e faktit, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432, pika 1, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “KPP”).

11. Neni 141/1 i Kushtetutës parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Edhe ligji procedural, në rastin konkret KPP-ja, në nenin 14/a parashikon, se: *“Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.”*. Gjithashtu, në nenin 437/1, shkronja “a” të Kodit parashikohet, se: *“1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se: a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;”*. Njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore është funksioni kryesor kushtetues i Gjykatës së Lartë.

11.1. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, pas një hulumtimi mbi jurisprudencën e gjykatave më të ulëta, si dhe çështjeve që janë në pritje për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, Kolegji konstatoi qëndrime të gjykatave që reflektojnë paqartësi në zbatimin e ligjit procedural penal që rregullon mënyrën e procedimit nga gjykata për çështje

që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, konkretisht nenit 471 i KPP-së. Konkretisht, vërehet se gjykatat e faktit kanë paqartësi dhe mungesë uniformiteti në lidhje me palët që duhet të marrin pjesë në procesin që zhvillohet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Konstatohet se gjykatat e vendit të ekzekutimit, në shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal, në disa raste e zhvillojnë seancën gjyqësore me pjesëmarrjen e të dënuarit, mbrojtësit të tij, prokurorit dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”), sikurse, për shembull, në shqyrtimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht” apo “shfuqizim vendimi për kalimin në mbikëqyrje të veçantë”. Në raste të tjera, sikurse në kërkesat me objekt “ulje dënimi” apo “shfuqizim mase disiplinore”, seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e të dënuarit, IEVP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por pa praninë e prokurorit apo mbrojtësit të të dënuarit. Kjo qasje e gjykatave ka reflektuar/gjeneruar më tej qëndrime jo uniforme të praktikës gjyqësore (përfshirë dhe Kolegjin Penal) edhe në drejtim të palës që ka të drejtën të paraqesë ankim (apel/rekurs) kundër vendimeve të dhëna nga gjykata e vendit të ekzekutimit lidhur me kërkesa të paraqitura gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

12. Për këtë arsye, në referim të nenit 14/a dhe 437/1, shkronja “a”, të KPP-së, Kolegji vlerësoi se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim zhvillimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me subjektet që legjitimohen të paraqesin ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, si dhe pasojat që sjell mosrespektimi i nenit 471, pika 4, të KPP-së. Në vijim, Kolegji verifikoi edhe faktin se në disa raste, ankimet ndaj masave disiplinore të caktuara nga IEVP-ja dhe Komisioni i Apelit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, janë shqyrtuar nga gjykatat e juridiksionit administrativ.

13. Pas zhvillimit të seancës së parë gjyqësore, që u shty për arsye procedurale, përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, prokurori Arqilea Koça, parashtroi në datë 3.2.2025, një kërkesë për zgjerimin e objektit të çështjeve ligjore të shtruara për zhvillim/njësimit të praktikës gjyqësore. Konkretisht, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është parashtruar kërkesa për të shtuar një çështje për njësimit, në lidhje me përcaktimin e juridiksionit (penal apo administrativ) të gjykatave që marrin në shqyrtim kërkesat e palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masa disiplinore). Në seancën gjyqësore të datës 20.2.2025, palët pjesëmarrëse u shprehën dakord me këtë kërkesë të Prokurorisë së Përgjithshme. Ky kërkim i Prokurorisë së Përgjithshme u vlerësua i drejtë edhe nga ana e Kolegjit, nisur nga problematikat e verifikuara në trajtimin e këtyre çështjeve nga praktika gjyqësore, fakt që është parashtruar edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

14. Për sa më sipër, Kolegji, mbështetur në nenin 438, pikat 1 dhe 6 të KPP-së, vendosi inicimin e procedurës së njësimit dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore, duke shtruar çështjet:

i. A legjitimohen Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të paraqitur ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave, që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal?

ii. Çfarë pasojë sjell zhvillimi i seancës pa pjesëmarrjen e prokurorit ose/dhe mbrojtësit të të interesuarit, sikundër përcakton neni 471, pika 4, i KPP-së?

iii. Cilat juridiksion (penal apo administrativ) i takon gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masa disiplinore e të tjera), gjykatës së shkallës të parë të juridiksionit të përgjithshëm apo gjykatës administrative të shkallës së parë?

15. Në seancë gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me çështjet e shtruara për njësimit/zhvillim mbajti këtë qëndrim (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmblodhur):

- Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk legjitimohen të paraqesin ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

- Zhvillimi i gjykimeve me objekt shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të dënimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 471, pika 4, e KPP-së, pa pjesëmarrjen e prokurorit ose dhe mbrojtësit të të interesuarit, i bën këto gjykime absolutisht të pavlefshme.

- Gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masat disiplinore) i takon juridiksionit penal, gjykatave të shkallëve të parë të juridiksionit të përgjithshëm të vendit të ekzekutimit.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, në lidhje me çështjet e shtruara për njësim/zhvillim mbajti këtë qëndrim (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Institucioni penitenciar ka një rol primar dhe duhet të ketë të gjitha të drejtat, përfshirë dhe detyrimin ligjor për të ankimuar vendimmarrjen e gjykatës, pra duhet të ketë pozitën e plotë të palës në procesin gjyqësor në vijimësi.

- Prania e organit të prokurorisë, duhet që të jetë aktive. Mbetet në çmimin e Kolegjit Penal për vlerësim të kësaj prezence, rast pas rasti dhe sipas objektit konkret të kërkesës që bëhet nga i burgosuri, pasi në disa objekte kërkesash nuk parashikohet prezenca e shprehur e prokurorit, sipas ligjit 81/2020, “Për të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

- Gjykatë kompetente për gjykimin e këtyre kërkesave me objekte të ndryshme në fazën e ekzekutimit është gjykata ku i dënuari është duke përmblusur dënimin e dhënë nga gjykata, ashtu siç sanksionohet në nenet 470 dhe 471 të KPP-së.

17. Mbrojtësi i caktuar për të gjykuarin, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim/zhvillim, mbajti këtë qëndrim:

- Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në cilësinë e organit publik që ka nxjerrë aktet administrative të kundërshtuara gjyqësisht, legjitimohen plotësisht të ushtrojnë ankim ndaj vendimmarrjes së gjykatave që kanë shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

- Në kushtet kur kemi të bëjmë me gjykime të karakterit administrativ prania e prokurorit në zhvillimin e seancave nuk është e nevojshme. Në gjykime të tilla, nuk shqyrtohen akte ose vendime të marra nga organi i prokurorisë. Për rrjedhojë, nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 471, pika 4, i KPP-së.

- Në kushtet kur konflikti gjyqësor ka nisur ndaj një akti të vendosur nga një organ administrativ, për rrjedhojë kompetenca lëndore i përket gjykatës administrative.

III. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

18. Kolegji, pasi trajtoi arsyet pse vendimmarrja në lidhje me çështjet e mësipërme duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuere/zhvilluese, vlerësoi të ndalet në trajtimin e çështjeve objekt njësimi. Në këtë trajtim edhe pse çështjet janë shtruar në renditje kronologjike, Kolegji do të fillojë analizën nga çështja e tretë e shtruar për njësim, pasi ajo vendos bazat për kuptimin e mëtejshëm të çështjeve që pasojnë. Kolegji vlerëson se, duke qartësuar më parë juridiksionin kompetent për shqyrtimin e kërkesave gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, krijohet një kornizë e qartë për të kuptuar më mirë legjitimitetin e institucioneve për të paraqitur ankime gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal dhe pasojat e zhvillimit të seancës pa pjesëmarrjen e prokurorit ose/dhe mbrojtësit të të interesuarit. Fillimisht, Kolegji ndalet në trajtimin e çështjes (së tretë) të shtruar për njësim dhe zhvillim.

i. “Cilit juridiksion (penal apo administrativ) i takon gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masa disiplinore e të tjera), gjykatës së shkallës të parë të juridiksionit të përgjithshëm, apo gjykatës administrative të shkallës së parë?”

19. Në funksion të arritjes së konkluzionit lidhur me këtë çështje vlerësohet e nevojshme pikë së pari të sqarohet se procesi penal ka për qëllim të konstatojë nëse një person i caktuar ka kryer një vepër penale, personalitetin e autorit të krimit dhe cilat janë sanksionet që duhet të zbatohen ndaj tij. Gjykimi penal ka një funksion “instrumental”, në lidhje me të drejtën penale materiale, në kuptimin që ai është një mjet i domosdoshëm për zbatimin e ligjit penal. Ky i fundit tregon faktet që përbëjnë vepër penale dhe sanksionet e parashikuara për ata që i kryejnë ato. Procesi penal synon të konstatojë faktet historike, që përbëjnë vepër penale, të identifikojë autorët dhe të njohë personalitetin e tyre. Në këtë vështrim, procesi penal nuk ka vetëm qëllim teorik për të rindërtuar të vërtetën për një fakt të kryer, por edhe një qëllim më të kufizuar, i cili konsiston në verifikimin nëse ky fakt përbën vepër penale dhe, në rastin pozitiv, në zbatimin e një sanksioni ndaj autorit që e kreu atë. Konstatimi i faktit dhe identifikimi i autorit të tij nuk ndjekin qëllime abstrakte apo “historike”, por shërbejnë për të vlerësuar nëse dhe se cilat sanksione penale duhen vendosur. Verifikimi i personalitetit të autorit të krimit bëhet i domosdoshëm nga karakteristika që e dallon sanksionin/dënimin “penal”. Ky i fundit ndryshon nga ato civile dhe administrative për arsyen se është në përpjesëtim me “personalitetin” e autorit të veprimit të kundërligjshëm. Në të kundërt, sanksioni civil është në përpjesëtim me dëmin që duhet të kompensohet; sanksioni administrativ është në përpjesëtim me interesin publik që është cenuar. Vetëm sanksioni penal është në përpjesëtim, përveç peshës së objektit të cenuar, edhe me personalitetin e autorit të veprës (neni 47/2 i Kodit Penal¹). Nga kjo rezulton se gjykimi penal ka veç të tjerave funksionin e konstatimit të personalitetit të autorit të veprës penale, me qëllim përcaktimin e sanksionit (dënimin) që duhet dhënë. Në kushtet kur sanksioni/dënimin penal ka, ndër funksionet e tij të shumta, edhe atë “riedukues” (që ka prirje të favorizojë riintegrimin social të të dënuarit), është thelbësore që një gjyqtar të konstatojë evoluimin e personalitetit të shkelësit edhe në fazën e ekzekutimit.

20. Kolegji ka vënë në dukje se “procedimi penal” dhe “procesi penal” nuk janë sinonime të njëri-tjetrit, referuar përmbajtjes së dispozitave të veçanta në KPP. Jurisprudenca dhe doktrina në Shqipëri ka theksuar, se me shprehjen “procedim penal” kuptohet një seri veprimesh apo aktesh, të kryera sipas një rendi të caktuar kronologjik, deri në dhënien e një vendimi penal, ku secili prej tyre, atëherë kur është kryer në mënyrë të vlefshme, sjell detyrimin për të vijuar me veprimin, aktin tjetër. Nga sa më sipër, kuptohet që në konceptin e procedimit penal përfshihen tri elemente thelbësore: i. së pari, ligji parashikon një “seri të rregulluar kronologjiksht” aktesh, veprimesh, në kuptimin që këto akte duhet të kryhen, duke respektuar një afat kohor të përcaktuar; ii. së dyti, të gjitha aktet, veprimet e procedimit kanë si qëllim të vërtetojnë ekzistencën e një fakti të paligjshëm penalisht dhe atribuimin e tij një personi. Kjo përbën objektin e procedimit, e thënë në terma latinë “*res giudicanda*”; iii. së treti, kryerja e një veprimi apo akti të procedimit lind “detyrimin” për subjektin tjetër për të kryer veprimin apo aktin pasues, e kështu me radhë, deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Procedimi penal i zakonshëm ndahet në tri faza: hetimet paraprake, seanca paraprake dhe gjykimi. Ndërkohë, me shprehjen “proces penal” kuptohet një pjesë e procedimit penal. Janë pjesë e “procesit penal” faza e seancës paraprake dhe gjykimi. Fillimi

¹ Neni 47/2 i Kodit Penal: “Në caktimin e dënimin ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.”

i procesit penal përkon me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori; ndërsa përfundon kur vendimi merr formë të prerë, d.m.th., kur vendimi penal është i paankimueshëm, pasi ndaj tij nuk është bërë ankim ose sepse janë shteruar të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit.²

21. Kolegji sjell në vëmendje se nga leximi i Kodit dy shprehjet “proces” dhe “procedim” zakonisht përdoren në kuptimin e tyre teknik. Shprehja “në çdo gjendje dhe shkallë të procesit”³ synon të përjashtojë një periudhë thjesht procedurale, pra fazën e hetimit paraprak. Shprehja “në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit”⁴ synon të përfshijë si hetimet, ashtu edhe gjykimin. Shprehja “shkallë” ka për qëllim të tregojë nëse gjyqtari merr njohje për objektin për të cilin duhet të vendosë, në shqyrtimin e parë (në gjykimin në shkallë të parë) ose në apel ose, së fundi, në rekursin në Gjykatën e Lartë. Shprehja “gjendje” synon të tregojë një fazë të procedurës; në procedimin e zakonshëm pasojnë njëra-tjetrën gjendjet (fazat) si vijon: hetimet paraprake, seanca paraprake, gjykimi. Ndërsa momenti përfundimtar i procedimit penal përfaqësohet nga ekzekutimi, të cilit KPP-ja i kushton një titull të tërë, të nëntin⁵. Rëndësia që merr ky moment në kuadrin e procedimit penal lidhet me domosdoshmërinë logjike që masat e marra si brenda ashtu edhe në përfundim të një gjykimi penal të mos mbeten një “letër e vdekur”, por të kenë efektivitetin e tyre. Fillimi i ekzekutimit të detyrueshëm është identifikimi i objektit të ekzekutimit: pra bëhet fjalë për të verifikuar se cilat masa kanë aftësinë për t’u ekzekutuar dhe në çfarë momenti e marrin këtë karakteristikë.

22. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore rregullohet nga neni 462 e vijues i KPP-së. Gjithashtu, ekzekutimi rregullohet nga ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet vënia në ekzekutim e një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë dhe vendimeve penale që ekzekutohen menjëherë, sipas nenit 462/2 të KPP-së⁶. Ligji i posaçëm nr. 79/2020 përmban rregulla specifike për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale. Ligji parashikon se, si rregull, vendimet penale ekzekutohen kur marrin formë të prerë, ndërsa përjashtimisht ligji parashikon rregulla specifike për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve penale. Gjatë ekzekutimit të vendimit penal sigurohet: ligjshmëria, përgjegjësia, paanshmëria dhe proporcionaliteti në veprimtarinë e subjekteve të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit penal; trajtimi human dhe respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të personit të arrestuar, të paraburgosur ose të dënuar; pjesëmarrja e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, përmes planifikimit të dënimit, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla.

23. Duke qenë se faza e ekzekutimit të vendimit penal përfshin një periudhë kohore të caktuar dhe një sërë veprimesh që lidhen me zbatimin në praktikë të vendimit penal, është normale që gjatë kësaj faze të lindin situata të reja, apo nevoja që u japin palëve të përfshira në ekzekutim të drejtën të paraqesin kërkesa të ndryshme gjatë kësaj faze që kërkojnë ndërhyrjen e gjykatës. Pavarësisht se vendimi penal është i formës së prerë dhe ka hyrë në

² Shih vendimin njësoes nr. 00-2023-2241 (312), datë 16.11.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³ Shih nenin 34/2 të KPP-së “2. Cilësia e të pandehurit ruhet në çdo gjendje dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit.” Neni 72/1 të KPP-së: “1. Mungesa e juridiksionit ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të gjykimin.” Neni 83/1 të KPP-së: “1. Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit.”

⁴ Shih për shembull, nenin 284/1 të KPP-së: “1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.” Neni 37/a/1 të KPP-së: “Marrëveshja që përmban kushtet e bashkëpunimit mund të lidhet në çdo gjendje dhe fazë të procedimit, edhe pasi vendimi penal ka marrë formë të prerë dhe është vënë në ekzekutim.”

⁵ Titulli IX – Ekzekutimi i vendimeve.

⁶ “Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes.”

fazën e ekzekutimit, kjo fazë nuk përbën thjesht një zbatim teknik apo formal të vendimit. Përkundrazi, gjatë ekzekutimit të vendimit penal mund të lindin rrethana të reja që kërkojnë kontroll dhe mbikëqyrje gjyqësore. Subjektet e përfshira si i dënuari dhe prokurori mund të paraqesin kërkesa pranë gjykatës kompetente, të cilat lidhen me mënyrën e zbatimit të vendimit penal, përfitime ligjore, trajtimin e të dënuarve etj. Ky kontroll dhe mbikëqyrje gjyqësore është i domosdoshëm për të garantuar që zbatimi i vendimit penal të jetë jo vetëm formal, por edhe në përputhje me të drejtën, gjendjen faktike dhe të drejtat e personit të dënuar. Mirëpo, në funksion të garantimit të zbatimit të drejtë të vendimeve penale është e rëndësishme të përcaktohet se cili është organi gjyqësor kompetent që do të ushtrojë funksione kontrolluese dhe mbikëqyrëse gjatë ekzekutimit të vendimit penal; pra cilit juridiksion gjyqësor (penal apo administrativ) i përket shqyrtimi dhe gjykimi jo vetëm i kërkesës së të dënuarit për shfuqizimin e masës disiplinore (sikundër është rasti konkret), por edhe i kërkesave dhe i pretendimeve të tjera të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Këto kërkesa dhe pretendime mund të kenë natyra (objekte) të ndryshme dhe parashikohen jo vetëm në legjislacionin procedural dhe material penal, por edhe në ligje të posaçme sikurse ligji nr. 79/2020 dhe ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

24. Kolegji rikonfirmon qëndrimin se juridiksioni është një çështje që përcaktohet ekskluzivisht nga Kushtetuta (neni 42), marrëveshjet ndërkombëtare (neni 6 i KEDNJ) ose nga ligji. Përcaktimi i saktë i çështjes së juridiksionit dhe të kompetencës është detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës sipas të cilit, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kështu, juridiksioni gjyqësor penal është parashikuar në nenin 69 të KPP-së, sipas të cilit juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. Gjykata penale shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj.

25. Gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, KPP-ja parashikon rastet që kërkojnë kontroll dhe mbikëqyrje, apo miratim gjyqësor, si: kur lindin dyshime mbi identitetin fizik të personit të burgosur (neni 472); kur një person është dënuar në vend të një tjetri për gabim në emër (neni 473); kur disa vendime janë dhënë kundër të njëjtit person për të njëjtin fakt (neni 474); kur ka disa vendimeve, të dhëna në procedime të ndryshme kundër të njëjtit person (neni 475); kur kërkohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit (neni 476); kur kërkohet lirimi me kusht apo revokimi i tij (neni 477); kur kërkohet revokimi i vendimit për shkak të shfuqizimit të veprës penale (neni 479); kërkesa/prendime për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara (neni 480). Jo vetëm këto, por KPP-ja parashikon shprehimisht se në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për çdo rast të parashikuar me ligj (neni 480). Faza e ekzekutimit të vendimit penal përfshin edhe disa kategori kërkesash të tjera të parashikuara në Kodin Penal (KP), sikundër lirimi me kusht (neni 64), kërkesa për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit (neni 68), amnistia (neni 71).

26. Ligji nr. 79/2020 ka për qëllim të garantojë ekzekutimin e vendimeve penale në përputhje me legjislacionin në fuqi, me standardet ndërkombëtare dhe në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (neni 1). Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dhëna nga gjykatat vendëse dhe të huaja në përputhje me KPP-në, KP-në, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj (neni 2, pika 2). Subjektet e ngarkuara me ekzekutimin e vendimit penal sipas këtij ligji, ushtrojnë kompetencat duke respektuar të drejtat, dinjitetin dhe liritë e personit.(neni 7, pika 1). Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal, në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij

ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës (neni 8). Gjithashtu, çdo person apo subjekt i urdhëruar nga prokurori për ekzekutimin e një vendimi penal, që gjatë procedurës së ekzekutimit është në dijeni të fakteve dhe rrethanave, të cilat ndikojnë në mënyrën dhe kohën e ekzekutimit të vendimit penal, ka detyrimin të njoftojë prokurorin, i cili me marrjen në dijeni të fakteve e rrethanave të reja, prokurori, pasi bën verifikimin, sipas rastit, ndërhyr bazuar në dispozitat e këtij ligji ose paraqet kërkesë në gjykatën kompetente (neni 9, pikat 1, 3).

27. Kolegji sjell në vëmendje se çështjet që lidhen me ndjekjen penale, dënimin dhe ekzekutimin e dënimeve, si dhe çdo aspekt që ndikon mbi mënyrën e ekzekutimit të një vendimi penal (p.sh. lirimi me kusht, shtyrja e ekzekutimit të dënimit, shuarja e veprës penale etj.), janë pa diskutim objekt shqyrtimi në juridiksionin gjyqësor penal, sipas rastit nga gjykata që ka dhënë vendimin e dënimit ose gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit. Këto kërkesa qartazi kanë natyrë penale, pasi ndikojnë drejtpërsëdrejti në zbatimin e vendimit gjyqësor penal dhe si rrjedhojë kërkojnë interpretim të legjislacionit penal. Ndërkohë, gjykata administrative shqyrtton konflikte midis individit dhe administratës publike, kur këto konflikte kanë të bëjnë me ligjshmërinë e akteve administrative, apo mosveprimet e organeve administrative. Ajo (gjykata administrative) nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në vendimet gjyqësore penale, aq më tepër në zbatimin apo ndryshimin e tyre, pasi kjo do të përbënte një ndërhyrje që i përket juridiksionit gjyqësor penal. Kërkesat e përmendura më lart, sikurse ajo për librim me kusht, shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, shuarjen e veprës penale, apo vlerësimin e identitetit të të dënuarit etj., kërkojnë vlerësim të fakteve dhe të së drejtës penale, gjë që i përket gjykatës penale, e cila ka specializimin dhe juridiksionin për të vendosur mbi çështje që lidhen jo vetëm me caktimin e dënimin penal por edhe me pasojat dhe mënyrën e ekzekutimit të tij. Për shembull, librim me kusht kërkon vlerësim nëse është arritur qëllimi i dënimit penal, për edukimin e të dënuarit dhe ky i fundit është i gatshëm të riintegrohet në shoqëri. Kjo është një çështje me natyrë penale dhe jo administrative. Për këtë arsye, kërkesat e përmendura në nenet 470-480 të KPP-së, si dhe në ligjin nr. 79/2020 i përkasin ekskluzivisht juridiksionit gjyqësor penal.

28. Kolegji vë në dukje se gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal mbikëqyrja dhe kontrolli gjyqësor nuk kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në KPP, KP-ja apo ligjin nr. 79/2020, por shtrihet edhe për kërkesa dhe ankesa që lidhen me të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, sipas parashikimeve në ligjin nr. 81/2020. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimi i sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente. Nëpërmjet këtij ligji garantohen kushtet për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Ligji nr. 81/2020 parashikon në parim të drejtën e të burgosurit për të paraqitur ankesa për kufizimin individual të të drejtave, ankesa për kufizimin në grup të të drejtave, si dhe kërkesa/ankesa për zbatimin e këtij ligji, legjislacionit në fuqi, të rregullores së përgjithshme të burgjeve, si dhe të rregullores së brendshme të institucioneve. E drejta e paraqitjes së ankimit dhe kërkesave përcaktohet në kreun II, *Parimet themelore*, në nenet 8, 9 dhe 10 të ligjit nr. 81/2020.

29. Në bazë të këtij ligji parashikohen shprehimisht rastet e aktivizimit të kontrollit dhe mbikëqyrjes gjyqësore mbi bazën e kërkesës dhe/ose ankesës së prokurorit, të dënuarit, apo mbrojtësit të tij ligjor. Kështu, në bazë të nenit 16 të këtij ligji i nënshtrohen kontrollit dhe

mbikëqyrjes gjyqësore caktimi dhe ndryshimi i llojit të sigurisë së burgut. Nga përmbajtja e dispozitës në fjalë parashikohet se si caktimi fillestar, po ashtu edhe ndryshimi i llojit të sigurisë së burgut nga ai i lartë në një të zakonshëm ose e kundërta, bëhet nga gjykata. Kjo e fundit vihet në lëvizje nga prokurori, i dënuari apo mbrojtësi i tij. Nuk parashikohet e drejta e IEVP-së të marrë vendim lidhur me caktimin dhe/ose ndryshimin e llojit të burgut të sigurisë së lartë, as mundësia që të paraqesë kërkesë të drejtpërdrejtë në gjykatë. IEVP-ja, nëpërmjet drejtuesit të tij, vetëm mund të vërë në lëvizje prokurorin. Ndërsa ndryshimi i klasifikimit të sigurisë së të dënuarve, që u ekzekutohet vendimi i dënimit në një institucion të sigurisë së zakonshme, kryhet nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve⁷, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 16 të ligjit nr. 81/2020. Kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, i dënuari, përfaqësuesi i tij ligjor ose prokurori mund të paraqesë ankim në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit (nenet 18 dhe 27/3). Kalimi i të dënuarve nga një institucion i sigurisë së zakonshme në një institucion të sigurisë së ulët, vendoset nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, me kërkesë të drejtorit të institucionit ku ekzekutohet vendimi ndaj të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor (neni 19). E njëjta kompetencë për Komisionin parashikohet edhe për transferimin e të dënuarit me burgim, ekzekutimi i dënimit të të cilit bëhet në një institucion të sigurisë së ulët, në një institucion të hapur (neni 20).

30. Ligji nr. 81/2020 parashikon aktivizimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes gjyqësore mbi bazën e kërkesës dhe/ose ankesës së të burgosurit, mbrojtësit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme edhe kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë, për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm ndaj të burgosurve në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë (neni 17). Kjo dispozitë parashikon se vendimi për vendosjen e të burgosurit në regjimin e posaçëm në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë ose zgjatjen e saj është objekt kontrolli gjyqësor. Gjykata vihet në lëvizje nga i burgosuri, mbrojtësi ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, por jo nga organe të administratës publike, pavarësisht se vendimi për vendosjen në këtë regjim merret nga ministri i Drejtësisë. Nga përmbajtja e pikës 10 të kësaj dispozite qartazi del se organet e administratës publike nuk kanë të drejtë ankimi ndaj vendimmarrjes së gjykatës, duke qenë se parashikohet detyrimi i ministrit të Drejtësisë që të zbatojë vendimin e gjykatës, kur është pranuar ankimi i paraqitur ndaj vendimmarrjes së tij (ministrit). Lidhur me këtë rast, ligji ka përcaktuar nominalisht gjykatën kompetente që është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

31. Ligji nr. 81/2020 parashikon në nenin 58 të drejtën e të burgosurit të paraqesë kërkesë ose ankesë drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimprurëse, vendëse dhe të huaja, prokurorit ose gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, si dhe personave që sipas nenit 51 të këtij ligji kanë të drejtë të vizitojnë institucionin. Kundër vendimit të organeve kompetente për kërkesën dhe/ose ankesën, ose kur ato nuk shprehen me vendim, parashikohet e drejta e të burgosurit që të ankohet në rrugë administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i burgosuri ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas parashikimeve të nenit 80 të këtij ligji (neni 59).

⁷ Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe ka në përbërje të tij 5 anëtarë, një përfaqësues të shërbimit të sigurisë, një përfaqësues të sektorit ligjor, një përfaqësues të sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues të shërbimit shëndetësor dhe specialisti i sektorit të kujdesit social, që trajton të dënuarin brenda institucionit.

32. Gjithashtu, ligji nr. 81/2020 në nenet 60–67 përcakton rregullat e disiplinës dhe për zbatimin e masave disiplinore, klasifikimin e shkeljeve disiplinore, masat parandaluese, masat disiplinore, organin kompetent për dhënien e masës disiplinore, procedurën për dhënien e tyre, si dhe ankimin e masave disiplinore. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa: a) këshillim individual; b) përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë; c) përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë; ç) përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë (neni 64). Masa disiplinore këshillim individual jepet nga drejtori i IEVP-së (neni 65/1). Masat e tjera jepen nga Komisioni Disiplinor pranë IEVP-së (neni 65/2), me vendim të arsyetuar (neni 66/6), pasi është dëgjuar i burgosuri (neni 66/1). Kundër vendimit mund të paraqitet ankim (67/1). Ankimi shqyrtohet nga Komisioni i Apelimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i cili disponon me vendim (neni 67/2). Sipas nenit 67/3 kundër vendimit të komisionit të apelimit i burgosuri ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente brenda 15 ditëve nga njoftimi me shkrim i vendimit. Sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të miratuar me VKM-në nr. 209/2022, parashikohet: “5. Në çdo rast Komisioni i Apelimit njofton me shkrim të burgosurin për vendimin e tij, duke i njohur me të drejtën e ankimit, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit në gjykatë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

33. Ligji nr. 81/2020 rregullon edhe vendosjen e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, kalim i cili bëhet me vendim të arsyetuar të drejtorit të institucionit pas marrjes së raportit të vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve. Vendimi i njoftohet menjëherë prokurorit, drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, të burgosurit dhe mbrojtësit të tij. I burgosuri ka të drejtë ta ankimojë urdhrin e drejtorit të institucionit në gjykatën kompetente brenda 10 ditëve nga njoftimi i urdhri (neni 68).

34. Ky ligj parashikon gjithashtu dhënien e lejeve shpërblyese ndaj të dënuarve, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës, rregulloren e brendshme të institucionit, janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrit, si dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Leja shpërblyese në institucionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhr të ministrit të Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga drejtori i përgjithshëm i Burgjeve. Ndërsa leja shpërblyese në institucionet e sigurisë së zakonshme dhe të ulët jepet me urdhr të drejtorit të institucionit. Kundër vendimit të refuzimit të lejes shpërblyese, i dënuari në institucionet e sigurisë së zakonshme ose të sigurisë së ulët, apo përfaqësuesi i tij ligjor mund të paraqesë ankim brenda 5 ditëve pranë ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në KPA. Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente. Kundër vendimit të refuzimit të lejes shpërblyese i dënuari në institucionet e sigurisë së lartë ose përfaqësuesi i tij ligjor, mund të paraqesë ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijeni (neni 72).

35. Gjithashtu, në bazë të këtij ligji, i burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit (neni 73). Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të refuzimit. I dënuari që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruese gjatë kryerjes së dënimit, mund të përfitojë ulje dënimi deri 90 ditë në çdo vit të kryerjes së dënimit⁸. Ulja e

⁸ Në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit 1

dënimin bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit, ose të përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit (neni 75).

36. Ligji nr. 81/2020 parashikon edhe rregullat për transferimin e të burgosurit nga një institucion për ekzekutimin e vendimeve penale në një tjetër (neni 78). Transferimi i të burgosurit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e të burgosurit ose anëtarëve të familjes së tij, prokurorit të çështjes ose drejtorit të institucionit. Në rast të refuzimit të kërkesës së transferimit, i burgosuri njoftohet me shkrim. Kundër vendimit të refuzimit i burgosuri ka të drejtë të paraqesë ankim pranë ministrit të Drejtësisë brenda 15 ditëve nga marrja dijeni. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për transferim, procedurën e shqyrtimit të saj dhe ekzekutimin e transferimit përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve. Ndërsa, sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve miratuar me VKM-në nr. 209, datë 6.4.2022 parashikohet: *“Në rast të refuzimit të kërkesës nga ministri i Drejtësisë, i burgosuri ka të drejtë ta ankimojë urdhrin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga vënia e tij në dijeni për refuzimin e kërkesës, në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.”* (neni 107, pika 10).

37. Kolegji konstaton se, përveç kërkesave të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal si dhe ligjin nr. 79/2020, ligji i posaçëm për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim nr. 81/2020, përcakton një sërë të drejtash dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, si dhe mjetet për mbrojtjen e tyre. Sipas këtij ligji parashikohet e drejta e të dënuarit me burgim që të mund të paraqesë kërkesa apo ankesa të ndryshme brenda sistemit penitenciar, apo edhe ndaj autoriteteve të tjera të jashtme. Të dënuarit me burgim kanë të drejtë të paraqesin kërkesa për përmirësimin e trajtimit në burg apo zbatimin e të drejtave, të bëjnë ankesa në rast se vlerësojnë se u janë shkelur të drejtat, apo janë trajtuar në kundërshtim me ligjin. Kërkesat e të dënuarve me burgim kanë natyrë të ndryshme dhe përveç rasteve të përmendura më sipër mund të lidhen edhe me kushtet e jetesës në burg (mjedisi i fjetjes, ajrimi, ushqimi, pastrimi, trajtimi mjekësor), kontaktin me familjarët (moslejimi i vizitave dhe telefonatave, kufizime në takime apo korrespondencë), shërbimin shëndetësor (mungesë trajtimi), përdorimin e masave disiplinore (vendime për caktim mase disiplinore, izolim apo kufizim i të drejtave), trajtim diskriminues (bazuar në gjini, etni, gjendje shëndetësore etj.), ushtrimin e dhunës, pretendime për planin individual të trajtimit (refuzim i arsimit, trajnimit profesional apo mungesë aktivitetesh, kërkesa për transferim (te një institucion më afër familjes, ose të një niveli më të ulët sigurie), ankesa lidhur me ndalimin e sendeve, ose kufizimin e korrespondencës etj. Ajo që vlen të theksohet lidhet me faktin se të gjitha këto kërkesa, ankesa apo pretendime paraqiten dhe bëjnë pjesë në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Vendimi penal përfundon ekzekutimin kur i dënuari përmbush të gjitha detyrimet që përmbahen në vendim, cilado qoftë mënyra e disponimit të gjykatës, apo mënyra e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.⁹ Kolegji rithekson se vetëm nga momenti që i burgosuri lirohet dhe i dënuari shlyen përfundimisht çdo dënim të dhënë ndaj tij, përfundon faza e ekzekutimit të vendimit penal.

38. Kuadri ligjor në fuqi parashikon përveç prokurorit një sërë organesh të tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal si Policia e Shtetit, Shërbimi Përmbarimor, Shërbimi i Provës, organet shtetërore dhe persona të tjerë juridik. Vlen për t'u theksuar se Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (institucionet penitenciare) bëjnë pjesë në organet që ligji i ngarkon me detyra specifike gjatë ekzekutimit të vendimit penal me burgim. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duke qenë institucione ku ekzekutohet dënimi me burgim

⁹ Shih vendimin njësoes nr. 00-2022-1036 (114), datë 7.4.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

kanë përgjegjësi për pritjen, sistemimin, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve. Tërësia e këtyre kompetencave që organi administrativ penitenciar ushtron në bazë të ligjit kundrejt të dënuarve me burgim mund të përbëjë shkak për lindje mosmarrëveshjes, në eventualitetin e ngritjes së pretendimeve në lidhje me këtë veprimtari, sikundër ka ndodhur në rastin konkret ku i dënuari ka kundërshtuar dhënien e masës disiplinore. Megjithatë, ushtrimi i kompetencave të dhëna me ligj nga institucionet penitenciare i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal, fakt ky që e kushtëzon dhe përbën faktor përcaktues për kompetencën lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë kërkesat e të dënuarit (burgosurit) me objekt kundërshtimin e veprimtarisë së tyre. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se është e vërtetë që konflikti krijohet, për shkak të veprimtarisë së një organi të administratës publike, por nga interpretimi i përmbajtjes së ligjeve të mësipërme, del shumë qartë se pretendimet dhe ankesat e të dënuarve me burgim nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat administrative, pasi nuk mjafton vetëm verifikimi i ligjshmërisë së aktit administrativ si veprimtari tipike administrative, por duhet që të vërtetohet se sjellja dhe veprimi i këtij organi të administratës publike në trajtimin e të dënuarit me burgim (burgosurit) ka synuar rehabilitimin për riintegrimin e të dënuarit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike, kushte këto që për nga vetë natyra e tyre i përkasin lëndës penale (në kuadër të funksionit rehabilitues dhe riedukues të dënimit penal) dhe si të tillë verifikohen nga juridiksioni gjyqësor penal (gjykata penale). Qëndrimi i konsoliduar jo vetëm i Kolegjit Penal, por i Gjykatës së Lartë në tërësi, është që kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet nga natyra e mosmarrëveshjes, nga lënda e së drejtës që pretendohet dhe jo nga subjektet pjesëmarrës në gjykim. Fakti që një nga palët në mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk do të thotë që mosmarrëveshja që lind me këtë organ i përket automatikisht gjykatës administrative, kur në thelb e drejta që pretendon pala i përket një lënde të caktuar, civile ose penale (*shih vendimin njëses nr. 00-2022-1036 (114), datë 7.4.2022, të KPGJL-së*).

39. Përveç sa më lart, vlen të theksohet se në dallim nga dinamika e gjykimit administrativ, në gjykimin penal, prokurori nuk vepron thjesht si palë në kuptimin klasik të fjalës, por si garant i ligjshmërisë së procesit dhe zbatimit të vendimit penal. Në fazën e ekzekutimit, prokurori ushtron një rol mbikëqyrës dhe korrigjues, duke siguruar që vendimi penal të zbatohet në përputhje me ligjin dhe që të mos cenohet as interesi publik, as të drejtat themelore të të dënuarit (burgosurit). Për rrjedhojë, kjo dinamikë, ku prokurori përfaqëson interesin publik dhe njëkohësisht garanton respektimin e të drejtave të njeriut, është karakteristikë thelbësore e juridiksionit gjyqësor penal dhe mungon në atë administrativ, ku raporti është kontradiktor ndërmjet individit dhe organit administrativ. Ndaj edhe në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se çdo kërkesë ose/dhe ankim që lidhet me mënyrën e ekzekutimit të vendimeve penale duhet të shqyrtohet nga gjykata penale, pasi vetëm kjo gjykatë, pasi ka dëgjuar edhe qëndrimin e prokurorit, mund të sigurojë një kontroll efektiv dhe të paanshëm të ekzekutimit të vendimeve penale. Ky kontroll nuk kufizohet në aspektin formal të aktit/veprimit administrativ, por shtrihet në thelb të procesit penal, duke mbrojtur zbatimin në mënyrën e duhur të vendimit gjyqësor penal dhe të drejtat themelore të të dënuarit (burgosurit).

40. Nga ana tjetër, Kolegji vë në dukje se neni 80 i ligjit nr. 81/2020 përcakton shprehimisht gjykatën kompetente, duke përcaktuar: “*Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.*” Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se është parashikuar e drejta e ankimit gjyqësor ndaj vendimeve që merren nga institucionet penitenciare (IEVP

dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve). Kjo përfshin të gjitha vendimet që ndikojnë në mënyrën e vuajtjes së dënimit, trajtimit e të dënuarve me burgim dhe detyrimet e tij brenda sistemit penitenciar. Qartazi kjo dispozitë përcakton se gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit penal është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa. Ky parashikim është në harmoni edhe me nenin 470 të KPP-së, i cili përcakton po të njëjtën gjykatë si kompetente lidhur me kërkesat apo pretendimet që paraqiten gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Referimi që neni 80 i ligjit nr. 81/2020 bën në zbatimin e parashikimeve të KPP-së, qartazi reflekton se këto ankime i përkasin juridiksionit gjyqësor penal dhe jo atij administrativ. Kjo do të thotë se edhe kur objekt ankimi është një vendim i një organi publik (sikundër ai i IEVP-së, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), kontrolli mbi këtë vendim bëhet nga gjykata penale, jo nga gjykata administrative. Kjo ka një domethënie: vendimi i organit administrativ ka pasoja në të drejtat e personit të dënuar dhe evoluimin e personalitetit të tij (si p.sh., mospërfitim i uljes së dënimit, lirimit me kusht, risocializimin dhe riintegrimin shoqëror etj.) dhe për pasojë drejtpërdrejt mbi mënyrën dhe cilësinë e zbatimit të dënimit gjatë fazës terminale të procedimit penal, fazë në të cilën ligjvënësi ka paraparë si subjekt kontrollues dhe mbikëqyrës gjykatën e ekzekutimit të vendimit penal.

41. Në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente në përmbajtjen e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për rastet e ankimeve lidhur me masat disiplinore dhe transferimet e të burgosurve (*shih më lart paragrafët 32 dhe 36*), Kolegji çmon se rregullorja në fjalë nuk mund të ndryshojë përmbajtjen e ligjit, aq më tepër të përcaktojë kompetencën e gjykatave, e cila përbën ekskluzivisht çështje ligjore. Në rastet kur ligji dhe akti nënligjor, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e çështjes, bien në kundërshtim me njëri tjetrin, gjykata ka detyrimin të bazohet në ligj. Sipas jurisprudencës kushtetuese, respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, për sa kohë si ligji nr. 81/2020 (neni 80), por veçanërisht edhe KPP-në (neni 470) kanë parashikuar gjykatën penale (gjykatën e ekzekutimit) për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve (kërkesa/ankesa), që burojnë nga ekzekutimi i vendimit penal, rregullorja si akt nënligjor nuk mund të përcaktojë një juridiksion tjetër gjyqësor nga ai që norma më e lartë parashikon. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve nuk mund të përcaktojë se cilit juridiksion gjyqësor penal apo administrativ i përket shqyrtimi dhe gjykimi i kërkesave/ankesave të të burgosurve, pasi ky juridiksion gjyqësor rregullohet me ligj, pra jo me akt nënligjor. Juridiksioni gjyqësor penal është i përcaktuar qartë në nenet 470 të KPP-së dhe 80 të ligjit nr. 81/2020, ndaj çdo dispozitë e aktit nënligjor zbatohet vetëm për aq sa nuk bie ndesh me ligjin dhe në çdo rast konflikti gjykata zbaton ligjin, si norma me fuqi më të lartë juridike dhe që ka epërsi në raport me rregulloren.

42. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji sjell në vëmendje se juridiksioni gjyqësor penal (gjykata penale) ka si qëllim vlerësimin e aspekteve që lidhen me ekzekutimin e dënimeve penale, duke përfshirë vlerësimin e personalitetit të të dënuarit, ecurinë e sjelljes së tij gjatë ekzekutimit në kuadër të risocializimit dhe riintegrit, si dhe përshtatshmërinë e masave alternative, parandaluese, ndëshkimore, apo përfitimeve ligjore (p.sh., masa disiplinore, libër me kusht, qëndrim në shtëpi, ulje dënimi, leje shpërblyese/veçantë etj.). Gjykata administrative, nga ana tjetër, ka në fokus kontrollin e ligjshmërisë së akteve administrative,

bazuar në ligje të fushës së të drejtës publike dhe nuk ka si qëllim interpretimin e parimeve të së drejtës penale, ose për të vlerësuar faktorë, si risocializimi dhe riintegrimi në shoqëri, që tipikisht janë lëndë të së drejtës penale. Ky dallim garanton që vendimet të jenë të bazuara në një analizë të thellë në funksion të arritjes së qëllimit të dënimit penal (parandalimit të recidivizmit, risocializimit dhe riintegritimit në shoqëri të të dënuarit, pra rehabilitimit të tij).

43. Edhe në një vështrim krahasues me legjislacionin e Republikës së Italisë, Kolegji vëren se në Itali, gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, përveç gjyqtarit të ekzekutimit (*Giudice dell'Esecuzione*), i cili ka rol të drejtpërdrejtë në interpretimin dhe ndryshimin e mënyrës së zbatimit të dënimit, funksionon edhe Magjistratura e Mbikëqyrjes (*Magistratura di Sorveglianza*), e përbërë nga Magjistrati Mbikëqyrës dhe Gjykata Mbikëqyrëse. Këta autoritete kanë kompetenca të gjera lidhur me trajtimin e të dënuarve gjatë ekzekutimit të vendimit penal, masat alternative ndaj burgimit, lirinë me kusht, rehabilitimin dhe kompensimin për trajtim të papërshtatshëm etj. Si në Shqipëri, edhe në Itali parashikohet kontrolli, survejimi dhe mbikëqyrja gjyqësore në fazën e ekzekutimit, por në ndryshim nga Italia, legjislacioni shqiptar lidhur me të gjitha kërkesat/prendimet që lindin gjatë ekzekutimit të vendimit penal ka parashikuar vetëm figurën e gjyqtarit të ekzekutimit të vendimit (dhe të survejimit/mbikëqyrjes për pasojë të ekzekutimit të dënimit), që synon jo vetëm të sigurojë ekzekutimin korrekt të vendimit penal të dënimit, por edhe të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria, nëpërmjet shqyrtimit të të gjitha kërkesave dhe pretendimeve që paraqiten gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal.

44. Edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së rezulton se pavarësisht natyrës së ligjit në tërësinë e tij, kur një veprim konkret ndikon në dënimin e një personi, veprimi merr natyrën e një akuze penale. Në çështjen *Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2003, §§ 128–129, gjykata gjeti, në veçanti, se dhëniet e ditëve shtesë të burgimit (42 ditë për shkelje disiplinore) nuk mund të konsiderohej si e parëndësishme dhe kështu përbënte “akuzë penale” ndaj kërkuesve në kuptim të nenit 6 të Konventës. Sipas GJEDNJ-së, është thelbësore që shtetet të kenë një hapësirë vlerësimi në lidhje me mjetet e përdorura për garantimin e sigurisë dhe rendit në një kontekst të vështirë, siç është burgu. Megjithatë, “drejtësia nuk përfundon në dyert e burgut” dhe të burgosurve nuk duhet t’u mohohen garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së. Çdo kufizim i këtyre të drejtave duhet t’i nënshtrohet kontrollit gjyqësor [...], me qëllim që të arrihet një ekuilibër i drejtë mes detyrimeve me të cilat përballet shteti në kontekstin e burgjeve, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të të burgosurve, nga ana tjetër (*shih vendimin e GJEDNJ-së - Ç k. Italisë, datë 17.9.2009, §§ 105–106*).

45. Në përfundim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se ekzekutimi i vendimit penal është një fazë përfundimtare e procedimit penal, e cila synon të garantojë që dënimi të zbatohet në përputhje me vendimin gjyqësor penal, në mënyrë proporcionale, si dhe duke marrë parasysh evoluimin e personalitetit të të dënuarit, në kuadër të risocializimit dhe riintegritimit të tij në shoqëri. Kërkesat dhe pretendimet gjatë kësaj faze lidhen drejtpërdrejt me interpretimin dhe mënyrën e zbatimit të dënimeve penale, jo me kontrollin e zakonshëm (tipik) të ligjshmërisë së akteve administrative. KPP-ja (nenet 470–480) dhe ligjet nr. 79/2020 dhe 81/2020 parashikojnë shprehimisht kompetencën e gjykatave penale në kontrollin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit. Referimet në nenin 80 të ligjit nr. 81/2020 dhe nenin 470 të KPP-së, e bëjnë akoma më të qartë se çdo ankim ndaj veprimeve të institucioneve gjatë fazës së ekzekutimit i drejtohet juridiksionit gjyqësor penal dhe si i tillë do t’i nënshtrohet gjykimit në gjykatën penale.

46. Për sa më lart, Kolegji mban këtë qëndrim njëses: **Gjykimi i kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal (masa disiplinore e të tjera) i takon juridiksionit penal¹⁰. Shqyrtimi i tyre do të bëhet nga gjykatat penale sipas legjislacionit procedural penal lidhur me ekzekutimin e vendimit penal.**

47. Pasi trajtoi çështjen e juridiksionit gjyqësor që ka kompetencën për të gjykuar kërkesat e palëve gjatë fazës së ekzekutimit penal, Kolegji ndalet në dyja çështjet e tjera që lidhen në thelb me palët e legjitimuara në proces dhe pasojën që sjell zhvillimi i seancës pa praninë e tyre.

ii. Në lidhje me çështjen e shtruar për njësim/zhvillim: “A legjitimohen Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për të paraqitur ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal?”

48. Kolegji, në analizë të dispozitave të zbatueshme në rastin konkret, vë në dukje se neni 470 i KPP parashikon: “1. Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.”. Ndërsa neni 471 i Kodit parashikon në pikat 1, 4 dhe 6, se: “1. Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit. ... 4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi ... 6. Gjykata merr vendim, i cili u njoftohet palëve edhe mbrojtësve. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, por ai nuk e pezullon ekzekutimin, përveçse kur gjykata që e ka dhënë vendos ndryshe.” Ndërsa neni 80 i ligjit nr. 81/2020 parashikon: “Kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se si ligji 81/2020, ashtu edhe KPP-ja, nuk parashikojnë shprehimisht të drejtën e IEVP-së apo të drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të vënë në lëvizje gjykatën e ekzekutimit të vendimit apo për të ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Neni 471 i KPP-së parashikon që, gjatë ekzekutimit të vendimit penal, gjykata mund të vendosë me kërkesë të të interesuarit (i dënuar/i burgosur), mbrojtësit të tij dhe prokurorit por jo të institucionit të vuajtjes së dënimit. Për çështje që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimeve penale zbatohen dispozitat e KPP-së dhe konkretisht nenet 470 dhe 471 të tij, të cilët parashikojnë, se ndaj vendimit që merr gjykata e ekzekutimit (gjykata e shkallës së parë e vendit nën juridiksionin e së cilës përfshihet institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale në çdo rast konkret) lejohet ankim, pa përcaktuar në mënyrë të shprehur mjetin e ankimit: apel apo rekurs.

49. Nga ana tjetër, neni 407 i KPP-së parashikon rastet dhe mjetet e ankimit. Ky nen parashikon: “1. Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit. 2. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit. 3. Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. 4. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. 5. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente.”, duke sanksionuar ndër të tjera edhe taksativitetin e rasteve dhe mjeteve të ankimit. Në referim të kuadrit ligjor të parashtruar më lart, Kolegji vlerëson se në zbatim të dispozitave procedurale dhe referuar parimit të taksativitetit, ligji procedural penal

¹⁰ Neni 69 i KPP-së me titull “Juridiksioni penal”: “1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Gjykata penale shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj.”

nuk ka parashikuar të drejtën e institucioneve penitenciare) për të ushtruar mjetin e ankimit kundër vendimit që jep gjykata e ekzekutimit të vendimit penal. Ndonëse IEVP-ja mund të marrë pjesë në seancë gjyqësore, nëpërmjet përfaqësuesit të saj (kur gjykata e çmon të nevojshme), ligji nuk i njeh të drejtën që të ankimojë vendimin e gjykatës, përderisa si ligji i posaçëm ashtu edhe KPP-ja, në lidhje me kërkimet në fazë të ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktojnë si palë prokurorin, të interesuarin (i dënuari/i burgosuri) ose mbrojtësin e tij.

50. Sipas nenit 470 të KPP-së, kompetenca për shqyrtimin e çështjeve gjatë ekzekutimit të vendimit penal i takon ekskluzivisht gjykatave penale. Ky juridiksion gjyqësor është i specializuar për të vlerësuar aspekte, që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal, personalitetin e të dënuarit, përshtatshmërinë e masave riedukuese, si dhe respektimin e të drejtave dhe mënyrën e trajtimit të të dënuarit gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si organe ekzekutive, nuk parashikohen si palë në këtë fazë dhe për rrjedhojë si rregull nuk mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatës që disponon për kërkesat e palëve (prokurorit, të interesuarit (i dënuari/i burgosuri) ose mbrojtësit të tij) të paraqitura gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji thekson, se procesi penal është një marrëdhënie midis shtetit (përfaqësuar nga prokuroria) dhe të dënuarit. IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve veprojnë si zbatues të urdhërimeve të gjykatës dhe jo si palë që tërheq interes të lidhur me mënyrën e ekzekutimit të vendimit penal. Në këtë kuptim, IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si rregull nuk legjitimohen për të paraqitur ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave penale që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, sikundër ato të parashikuara në KPP, KP dhe në ligjin nr. 79/2020.

51. Pavarësisht sa më lart, Kolegji vlerëson se kur gjykata e ekzekutimit të vendimit shqyrton një akt administrativ (p.sh., vendim për masë disiplinore, refuzim për transferim, leje shpërblyese, leje të veçantë, vendim për kalimin e të burgosurit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë etj.) sipas ligjit nr. 81/2020, IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë organe administrative që kanë marrë vendimin në fjalë (për dhënie mase disiplinore, refuzim i lejes shpërblyese, lejes së veçantë, transferimit, kalim në regjim të mbikëqyrjes së veçantë etj.). Në këto raste, ato legjitimohen si palë në proces dhe kanë të drejtë të paraqesin ankim. Ky përjashtim rrjedh nga neni 80 i ligjit nr. 81/220, i cili lejon ankimin e akteve të tyre në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me parashikimet e KPP-së. Në këto situata, IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve legjitimohen si palë në proces dhe kanë interes ligjor për të mbrojtur ligjshmërinë e aktit të vet administrativ (vendimin e tyre), prandaj kanë të drejtë të paraqesin ankim.

52. Në një vështrim krahasues me legjislacionin italian, ky i fundit në Rregulloren Penitenciare)¹¹, parashikon rastet se kur administrata e burgut mund të bëjë rekurs për shkelje të ligjit, duke përcaktuar në nenin 71 ter: “1. Kundër urdhrave të Gjykatës Mbikëqyrëse dhe të Magjistratit Mbikëqyrës, prokurori publik, i interesuari dhe, në rastet e parashikuara në nenet 14 ter dhe 69, paragrafi 6, administrata e burgut, mund të bëjnë rekurs për shkelje të ligjit brenda dhjetë ditëve nga komunikimi i vendimit. Zbatohen dispozitat e paragrafit të tretë të nenit 640 të KPP. Zbatohet edhe paragrafi i fundit i nenit 631 të KPP.”. Neni 14 ter¹²,

¹¹ “*Ordinamento Penitenziario*” (Rregullorja Penitenciare), e kodifikuar në ligjin nr. 354 të vitit 1975, i cili përcakton parimet, të drejtat dhe detyrimet e personave të privuar nga liria.

https://www.normattiva.it/atto/caricaDettaglioAtto?atto_dataPubblicazioneGazzetta=1975-08-09&atto.codiceRedazionale=075U0354&tipoDettaglio=vigente&qId=&dataVigenza=15/10/2023&generaTabId=true&bloccoAggiornamentoBreadCrumb=true&title=lbl.dettaglioAtto&tabID=

¹² Neni 14 (ankesa).

i referuar në këtë dispozitë, lidhet me ankesa ndaj urdhrit që vendos ose zgjeron regjimin e mbikëqyrjes së veçantë. Ndërsa, neni 69/6 i referuar më lart parashikon funksionet dhe vendimet e Magjistratit të Mbikëqyrjes, ndër të tjera: “6. Merr masa në bazë të nenit 35 bis për ankesat e të burgosurve dhe të dënuarve lidhur me: a) kushtet për ushtrimin e pushtetit disiplinor, konstituimi dhe kompetenca e organit disiplinor, kontestimi i akuzave dhe kompetenca e shfajësimit; në rastet e përmendura në nenin 39, paragrafi 1, numrat 4 dhe 5, vlerësohet edhe merita e masave të marra; b) moszbatimi i dispozitave të këtij ligji dhe rregullores përkatëse nga ana e administratës, që rezulton në dëmtim aktual dhe serioz në ushtrimin e të drejtave të të burgosurit ose të dënuarit.”.

53. Duke përmbledhur, arrihet në përfundimin se në një proces ku i dënuari kundërshton një akt administrativ të IEVP-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, vetë burgu nuk është iniciues i procesit penal por palë e interesuar (si subjekt vendimmarrës), i thirrur në gjykim për të dhënë qëndrim dhe mbrojtur ligjshmërinë e aktit të tij administrativ përballë gjykatës. Në këtë kuptim, nëse gjykata e ekzekutimit të vendimit penal shfuqizon një akt administrativ të burgut, ky i fundit mund të ushtrojë ankim në një gjykatë më të lartë, për të mbrojtur ligjshmërinë e aktit të saj administrativ, sipas parashikimeve të KPP-së. Organi administrativ (burgu) nuk është palë që kërkon mbrojtjen e të drejtave të veta, por organ që jep “llogari” për vendimmarrjen e vet. Vetëm në këto raste, thekson Kolegji, IEVP dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë legjitimitet aktiv për të ankimuar shfuqizimin e vendimit të tyre, jo pse janë subjekte të dëmtuara, por për të kundërshtuar vlerësimin gjyqësor të veprimit të vet në një gjykatë më të lartë. Institucioni penitenciar (burgu) nuk dëmtohet nga aktet e veta por përkundrazi, ai është organi që ka ushtruar pushtetin publik dhe si i tillë, është subjekt i kontrollit, jo subjekt i mbrojtjes aktive në gjykatë.

54. Për sa më lart, Kolegji mban këtë qëndrim njësuës/zhvillues: **Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk legjitimohen për të paraqitur ankim kundër vendimmarrjes së gjykatave penale që kanë shqyrtuar kërkesa të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Ky rregull nuk gjen zbatim vetëm në rastet kur objekt shqyrtimi gjyqësor në gjykatat penale është akti administrativ (vendimi i administratës së burgjeve), sipas parashikimeve të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Në këto raste Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve thirren si palë dhe legjitimohen të paraqesin ankim.**

iii. Në lidhje me çështjen e shtruar për njësim/zhvillim: “Çfarë pasoje sjell zhvillimi i seancës pa pjesëmarrjen e prokurorit ose/dhe mbrojtësit të të interesuarit, sikundër përcakton neni 471, pika 4 i Kodit të Procedurës Penale?”

55. Kolegji vë në dukje se prokurori është subjekt i procedimit penal. Prokurori vepron si palë publike në procedimin penal. Ai përfaqëson interesin e përgjithshëm të shtetit/shoqërisë, pra interesin e komunitetit që është dëmtuar nga vepra penale. Neni 24 i KPP-së parashikon funksionet e prokurorit, duke përcaktuar, ndër të tjera: “1. Prokurori ..., merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre,” Neni 463 i KPP-së

1. Pala e interesuar mund të apelojë kundër urdhrit që vendos ose zgjeron regjimin e mbikëqyrjes speciale në gjykatën mbikëqyrëse brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i urdhrit përfundimtar. Ankesa nuk pezullon zbatimin e urdhrit.

2. Gjukata mbikëqyrëse lëshon një urdhër në dhomë brenda dhjetë ditëve nga marrja e ankesës.

3. Procedurat zhvillohen me pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës dhe prokurorit publik. Pala e interesuar dhe administrata e burgut mund të paraqesin shkresa.

4. Përveç nëse parashikohet ndryshe, zbatohen dispozitat e kapitullit II-bis të titullit II.

parashikon: “1. Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit”. Neni 462/4 i KPP-së përcakton: “4. Mënyra e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë.”.

56. Ndërsa ligji nr. 79/2020 në nenin 11, përcakton: “1. Prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji. 2. Prokurori mban dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit.”

57. Në nenin 21, pika 1 të këtij ligji përcaktohet: “1. Organet kompetente për ekzekutimin e vendimit penal njoftojnë prokurorin për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit të vendimit. ...” Më tej, neni 67 përcakton: “1. Kontrolli procedural për ekzekutimin e vendimeve bëhet nga prokurori pranë gjykatës që ka dhënë vendimin. Kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një rreth të ndryshëm nga ai i gjykatës që ka dhënë vendimin, kompetent për kontrollin procedural është prokurori i rrethit ku kryhet ekzekutimi. 2. Gjykata që ka dhënë vendimin ose gjykata e vendit ku ekzekutohet dënimi, për çështjet në kompetencë të saj që dalin gjatë ekzekutimit ka të drejtë të kërkojë njoftime nga prokurori dhe organi ku ekzekutohet vendimi dhe, kur e sheh me vend, kontrollon drejtpërdrejt rregullsinë e ekzekutimit.”.

58. Neni 68 i ligjit nr. 79/2020 parashikon format e kontrollit të prokurorit, duke përcaktuar se “Prokurori realizon kontrollin nëpërmjet: a) marrjes së njoftimit për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit nga organi përkatës; b) shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të të arrestuarve, të paraburgosurve, të dënuarve dhe mbrojtësve të tyre; c) kërkit të informacioneve dhe verifikimeve të drejtpërdrejta për dokumente ose në vendin e kryerjes së dënimit në prani të personit zyrtar përkatës; ç) marrjes dhe verifikimit të njoftimeve për fakte dhe rrethana që ndikojnë në ekzekutimin e vendimeve; d) marrjes së mendimit të specialistëve të fushave të ndryshme; dh) bashkëpunimit me kontrollin e brendshëm të organit ku ekzekutohet vendimi ose të institucioneve shtetërore të kontrollit administrativ ...”.

59. Duke iu rikthyer edhe njëherë përcaktimit të nenit 471, pikat 1 dhe 4 të KPP-së, parashikohet: “1. Gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit. ... 4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi”.

60. Në analizë të kuadrit ligjor të sipërcituar, Kolegji thekson se në fazën e ekzekutimit të vendimit penal rol parësor ka figura e prokurorit. Roli i prokurorit nuk mbaron me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal por ai është kontrollues dhe mbikëqyrës gjatë gjithë kohës që ekzekutohet një vendim penal. Faza e ekzekutimit penal është faza terminale e procedimit penal, i cili përfundon vetëm nga momenti që i burgosuri lirohet dhe i dënuari shlyen përfundimisht çdo dënim të dhënë ndaj tij. Në këtë kuptim, në fazën e ekzekutimit rol parësor ka figura e prokurorit; në fakt, ndër funksionet e tij, përfshihet ajo që “*merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale (...)*”. Kjo konfirmohet në nenin 463/1 të KPP-së, i cili përcakton detyrën e prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, që të marrë masa për ekzekutimin e vendimit. Ai (prokurori) bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

61. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme thekson me të drejtë se prokurori ushtron kompetencat e përcaktuara në ligj, lidhur me ekzekutimin e vendimit penal, në mënyrë që nga një anë të sigurojë zbatimin korrekt të vendimit të gjykatës në funksion të interesit publik dhe nga ana tjetër të sigurohet se i dënuari do të përfitojë ato të drejta që i takojnë dhe nuk do të jetë viktimë e qëndrimeve arbitrare të institucioneve të caktuara për ekzekutimin e

vendimeve penale. Për këtë arsye si ligji nr. 79/2020 dhe në veçanti neni 471, pika 4 i KPP-së, parashikojnë zhvillimin e procesit të ekzekutimit me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësit. Pra qartazi neni 471, pika 4 e KPP-së e bën të detyrueshme shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që paraqiten në fazën e ekzekutimit të vendimit penal nga gjykata e ekzekutimit, në praninë e prokurorit dhe mbrojtësit të të interesuarit.

62. Kolegji rithekson se sistemi procedural penal shqiptar nuk lejon hapësirë për zgjedhje dhe dikton pjesëmarrje të domosdoshme të prokurorit në procedim, në çdo rast kur ligji parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e tij.¹³ Ligjvënësi shqiptar i lidh rastet e pavlefshmërive absolute, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 128/a, vetëm me subjektet kryesore të procedimit: me gjyqtarin (shkronja “a”), me prokurorin (shkronja “b” dhe me të pandehurin e mbrojtësin e tij, si dhe viktimën (shkronja “c”). Ajo që ka rëndësi për çështjen e shtruar për njësim, lidhet me rastin e pavlefshmërisë absolute të parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 128/a, pika 1 të KPP-së. Kjo dispozitë parashikon, se *“1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme, kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim; c) thirrjen e të pandehurit, viktimës ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.”*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, KPP-ja sanksionon me pavlefshmëri absolute kur nuk respektohen dispozitat për pjesëmarrjen e mbrojtësit, vetëm kur prania e tij është e detyrueshme, ndërsa lidhur me prokurorin, kur cenohet e drejta e tij për ushtrimin e ndjekjes penale ose/dhe pjesëmarrja e tij në procedim.

63. Në analizë të nenit 128/a, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të KPP-së, pavlefshmëria absolute e akteve që lidhen me prokurorin mund të ngrihet apo konstatohet vetëm në rastin kur nuk respektohen dispozitat që parashikojnë pjesëmarrjen e tij në procedim ndërsa për mbrojtësin e të interesuarit kur prania e tij është e detyrueshme. Neni 470/1 i KPP-së ka përcaktuar se gjykata procedon me kërkesën e prokurorit, të interesuarit ose të mbrojtësit, ndërsa lidhur me procedurën që duhet të zbatohet kjo dispozitë parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe mbrojtësit. Si rrjedhojë, duke qenë se zgjedhja e ligjvënësit ka qenë që në procesin e ekzekutimit të marrin pjesë detyrimisht prokurori dhe mbrojtësi i të interesuarit, zhvillimi i seancës pa praninë e tyre, sipas nenit 128/a, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të KPP-së, sanksionohet me pavlefshmëri absolute të aktit (vendimit).

64. Në vijim të këtij arsyetimi, arrihet në përfundimin se referuar neneve 471/5 dhe 128/a, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të KPP-së, cenimi i pjesëmarrjes së prokurorit në procedim (ku përfshihet edhe faza terminale e ekzekutimit) dhe mbrojtësit të të interesuarit, nëpërmjet zhvillimit të seancës pa pjesëmarrjen e tyre, në kushtet kur është e detyrueshme prania gjatë procesit të ekzekutimit, shkakton pavlefshmëri të aktit, vendimit të gjykatës që ka zhvilluar procesin gjyqësor pa pjesëmarrjen e këtyre palëve. Vlen të theksohet, se ndryshe nga pavlefshmëritë relative, sanksioni i pavlefshmërisë absolute mbron interesa thelbësore të palëve që lidhen me parime themelore të procesit penal, ndaj paragrafi i dytë i nenit 128/a të KPP-së vendos një sanksion të prerë: *“Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm.”*. Kjo do të thotë, se aktet absolutisht të pavlefshëm nuk mund të korrigjohen, sipas rregullave që normon neni 130 i KPP-së. E vetmja mundësi është që akti të ribëhet nga e para, pasi procedimi të kthehet pas, pikërisht në fazën ku është shkaktuar pavlefshmëria absolute. Nga ana tjetër, pavlefshmëritë absolute ngrihen edhe kryesisht nga organi para të cilit ndodhet çështja edhe kur pala e interesuar, së cilës i është cenuar një interes nga akti i pavlefshëm nuk vepron.

¹³ Shih vendimin njësoes nr. 00-2025-1007 (82), datë 27.3.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

65. Referuar parashikimeve ligjore dhe interpretimit të mësipërm, Kolegji mban këtë qëndrim njëses/zhvillues: **Zhvillimi i seancës pa pjesëmarrjen e prokurorit ose/dhe mbrojtësit të të interesuarit, sikundër përcakton neni 471, pika 4, i KPP-së, sjell pavlefshmërinë absolute të aktit (vendimit).**

A. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

66. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila u bë shkak për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson se IEVP-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve legjitimohen të paraqesin ankim ndaj vendimmarrjes se gjykatave të faktit, pasi objekt shqyrtimi është disponimi i tyre, në lidhje me masën disiplinore të dhënë ndaj kërkesit R. H. Por, Kolegji thekson se shqyrtimi i ankimit të të dënuarit nga gjykatat e faktit është zhvilluar pa praninë e prokurorit, në kundërshtim me urdhërimet e nenit 471, pika 4, të KPP-së. Kolegji vlerëson që në këtë rast ndodhemi para pavlefshmërisë absolute të aktit (vendimeve gjyqësore që kanë disponuar mbi kërkesën e të dënuarit R. H.). Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se kjo çështje duhet dërguar për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, pavarësisht objektit dhe gjendjes aktuale të ekzekutimit të vendimit penal të dhënë ndaj të dënuarit R. H. Kjo për arsye se, aktet absolutisht të pavlefshme nuk mund të korrigjohen, sipas rregullave që normon neni 130 i KPP-së. E vetmja mundësi është që akti të ribëhet nga e para, pasi procedimi të kthehet pas, pikërisht në fazën ku është shkaktuar pavlefshmëria absolute, që në rastin konkret bazuar në vendimin nr. 495, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencat tokësore të gjykatave”, kjo çështje do të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 441, pika 1, shkronja “ç”, dhe 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 10-2021-801 (128), datë 28.4.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr. 12-2020-1895 (369), datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Ky vendim është njëses dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 3.4.2025.

Kryesues: Ilir Panda

Anëtarë: Sokol Binaj, Medi Bici, Albana Boksi, Sandër Simoni